

Pyetësor

1. Çfarë kuptojmë me termin “përthyerje”?
 - Manipulimi i dritës për të krijuar breza drite dhe errësire, që kalojnë në një pengesë
 - Ndryshimi i drejtimit të dritës, kur kalon nga një mjedis në një tjetër
 - Aftësia e dritës për t’u shpërhapur dhe për të mbushur një dhomë
 - Aftësia e dritës për të depërtuar trupa të ngurtë
2. Si punon një lente?
 - Formon një shëmbëllim duke përthyer dritën.
 - Formon një shëmbëllim në bazë të dukurisë së difraksionit.
 - Formon një shëmbëllim duke përhapur dritën.
 - Bën fotografi me një kamera digjitale.
3. Si emërtohet largësia nga qendra e lentes deri te vatra kryesore?
 - Gjatësi vatrore
 - Largësi vatrore
 - Lartësi vatrore
 - Pikë vatrore
4. Cila është formula e saktë, që përcakton se si treguesi i përthyerjes është i lidhur me këndin e rënies dhe këndin e pasqyrimit?
 - Treguesi i përthyerjes = $\sin i / \sin r$
 - Treguesi i përthyerjes = $\sin r / \sin i$
 - Treguesi i përthyerjes = $\sin i / 2 \sin r$
 - Treguesi i përthyerjes = $2 \sin i / \sin r$
5. Çfarë përfaqëson i në ekuacionin e mësipërm?
 - Normalen
 - Këndin e përthyerjes
 - Këndin e rënies
 - Treguesin e përthyerjes
6. Natyra e shëmbëllimit të prodhuar nga lentja është përcaktuar në bazë të cilave attribute?
 - Në bazë të madhësisë së shëmbëllimit
 - Nëse shëmbëllimi është i drejtë ose i përmbysur në lidhje me objektin
 - Nëse shëmbëllimi është real dhe virtual
 - Të gjitha të mësipërmet

7. Cila prej lenteve të mëposhtme do të ishte një zgjedhje e mirë për të zmadhuar një objekt?

- Lentja divergjente
- Lentja shpërndarëse
- Lentja konvergjente
- Lentja Bi shpërndarëse

8. Sa është këndi i përrhyerjes i një mjedisi ku drita bie me një kënd 45^0 te normalja dhe këndi i përrhyerjes është 30 nga normalja?

- 1,1
- 1,2
- 1,3
- 1,4

Pyetjet	1	2	3	4	5	6	7	8
Përgjigjja e saktë	2	1	2	1	3	4	3	4